



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIM**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për vlerësimin e kërkesave të organizatave të shoqërisë civile sipas njoftimit publik, për nominim në Komisionin vlerësues të thirrjes publike 1Nr.660-30718 e datës 15.05.2018, për subvencionimin e OJQ-ve (Klubeve Sportive) në Komunën e Lipjanit në përbërje si vijon:

1. Behar Aliu, Drejtorati për Administratë, kryesues
2. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare
3. Islam Kaleshi, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e kërkesave të organizatave të shoqërisë civile për nominim në Komisionin vlerësues për subvencionimin e OJQ-ve (Klubeve Sportive) në Komunën e Lipjanit .

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 660-33976
Lipjan, më 31.05.2018

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

